POSTA SHQIPTARE SH.A
NR. 2316 Prot
Date 21. 07. 2016

POSTA SHQIPTARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
KESHILLI MBIKQYRES

Adresa: Terminali Center , Kthesa e Kamzës, pranë spitalit "Hygeia", Kodi Postar 1001, Tel&Fax 042 222 315, www.postashqiptare.al

V E N D I M

Nr. 21 . Datë 21 .07 . 2016

Mbi

Miratimin e Marrëveshjes, Raportit të Bashkimit me Përthithje dhe Raportit te Ekspertit Kontabel, per perthithjen e "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a

Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a. i përbërë nga:

SOKOL DERVISHAJ	Kryetar
MARINELA LIKA	Anëtar
IRENA MALOLLI	Anëtar
ZAMIR MOÇKA	Anëtar
DIANA DERVISHI	Anëtar
HASAN HOXHA	Anëtar

Në mbledhjen e saj të datës 21 . 07 .2016, ora ___ / ___ të zhvilluar në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shoqërisë,

Në mbështetje Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995"Për transformimin e ndërrmarjeve shtetërore në shoqëri tregtare" I ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 46, datë 07.05.2015 "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 642 dt. 11.10.2005, "Për Këshillat Mbikqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore Sh.a", Urdhërit të Ministrisë Nr.6016/1 datë 25.09.2015, si dhe Urdhërit Nr.6016/3 datë 10.12.2015 te MZHETTS, Statutit te shoqerise, pasi shqyrtoi dhe diskutoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shoqërisë, për **"Bashkimin me Përthithje të "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a** me unanimitet:

V E N D O S I:

1- Të miratoj Marrëveshjen me shoqërinë "Interpost" shpk me objekt: *"Bashkimin me Përthithje të "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a*

2- Te miratoje Raportin e Bashkimit të shoqërive, nënshkruar nga Administrator I Përgjithshëm i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a

3- Të miratojë raportin e paraqitur nga Eksperti Kontabël, zj. Diana Ylli (Golemi)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKQYRËS

SOKOL DERVISHAJ

Konc. Denada Veliqoti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - POSTA SHQIPTARE SH.A - TIRANË - DREJTORIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INTERPOST SHPK
ASAMBLEJA E PERGJITHSME

Adresa: Terminali Center , pranë spitalit "Hygeia", Kodi Postar 1001, Tel&Fax 042 222 315, www.postashqiptare.al

VENDIM

Nr. 10 . Datë 26 . 07 . 2016

Mbi

Miratimin e Marreveshjes së bashkimit, Raportit te Bashkimit me Përthithje të "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a dhe Raportit të Ekspertit Kontabël

Asambleja e Pergjithshme e shoqërisë "Interpost" shpk, në mbledhjen e saj të datës ____.____. 2016, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërrmarjeve shtetërore në shoqëri tregtare" I ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Urdhërit të Ministrisë Nr.6016/1 datë 25.09.2015, si dhe Urdhërit Nr.6016/3 datë 10.12.2015 te MZHETTS, vendimit nr. 5 date 26.12.2015 te Asamblese se Pergjithshme, Statutit të shoqërisë, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administratori i Shoqerise, për **"Bashkimin me Përthithje të "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a**

VENDOSI:

1- Të miratoj Marrëveshjen me shoqerine "Posta Shqiptare" shpk me objekt: *"Bashkimin me Përthithje të "Interpost" sh.p.k nga "Posta Shqiptare" sh.a*

2- Të miratojë Raportin e Bashkimit të shoqërive, nënshkruar nga Administrator I Përgjithshëm I shoqërisë "Interpost" sh.p.k.

3- Të miratojë Raportin e peragatitur nga Eksperti Kontabël për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Interpost" shpk nga "Posta Shqiptare" sh.a.

4- Prishjen pa likujdim të shoqërisë "Interpost" shpk

5- Të reflektohen këto ndryshime në rregjistrin tregtar pranë QKB dhe Administraten Tatimore

Kjo kopje vendimi është e vlefshme vetëm për depozitim pranë QKB.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

AKSIONERI
Shoqëria "Posta Shqiptare" sha

Administratori

Majlind LAZIMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHTETËRORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

POSTA SHQIPTARE SH.A
NR. 2322/1 Prot.
Date 05.08.2016

URDHËR

Nr 6268/1 Datë 4.8.2016

PËR

MIRATIMIN E BILANCIT TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE "POSTA SHQIPTARE" SH.A TIRANË.

DREJTUAR: " POSTA SHQIPTARE " SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" , Urdhrit Nr. 448, date 20.10.2014 " Për bashkimin me përthithje të shoqërisë "Interpost" sh.p.k, Tiranë nga shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a, Tiranë dhe Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës Nr.21 datë 21.07.2016 të shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a, Tiranë me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë " Posta Shqiptare" sh.a Tiranë :

URDHËROJ:

1. Kapitali i shoqërisë përthithëse " Posta Shqiptare" sh.a Tiranë, pas bashkimit mbetet 1 642 447 000 lekë i barabartë me 1 642 447 aksione me vlere nominale 1000 lekë secila.
2. Shoqëria "Interpost" sh.p.k Tiranë pas përfundimit të bashkimit, vlerësohet e prishur, sipas nenit 220 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2014 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ndaj çregjistrohet nga QKB, sipas seksionit V të Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 " Për Regjistrimin e Biznesit".
3. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, i ndryshuar " Për Regjistrimin e Biznesit " ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Posta Shqiptare " sh.a Tiranë për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MILVA EKONOMI

2663
01.7.2011

MARRËVESHJEA E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Ndërmjet

POSTA SHQIPTARE SH.A
Si Shoqëri Përthithëse

Dhe

INTERPOST SH.P.K
Si Shoqëri e Përthithur

POSTA SHQIPTARE SH.A
Nr.2063/ Prot. më 01 / 07 / 2016

INTERPOST SH.P.K
Nr.64 Prot, më 01/07/2016

MARRËVESHJE E BASHKIMIT ME PËRTHITHJE I SHOQËRISËINTERPOSTA SHPK NGA "POSTA SHQIPTARE "SHA"

Kjo Marrëveshje bashkimi me përthithje është hartuar nga:

- **Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, z. Majlind Lazimi**
  dhe
- **Administratori i shoqërisë Interpost sh.p.k, z.Kujtim Sejati**

Projekti i Bashkimit është iniciuar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të INTERPOST sh.p.k nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

1. POSTA SHQIPTARE sh.a, shoqëri anonime me kapital të regjistruar prej 1,642,447,000 lekë, i ndarë në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Rrugën Reshit Çollaku, nr 4, Tiranë dhe krijuar me vendimin e gjykatës Tiranë nr. 20718 datë 03.02.1992, e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë z.Majlind Lazimi, që për qëllim të kësaj marrëveshje POSTA SHQIPTARE sh.a do të quhet "Shoqëria Përthithëse",

   dhe

2. INTERPOSTA shpk, shoqërime përgjegjësi të kufizuar me kapital themeltar të regjistruar prej 1,000,000 lekë, i ndarë në1,000 kuota me vlerë 1,000 lekë/kuotë, tërësisht i paguar,me adresëtëregjistruar nëRrugën Reshit Çollaku, nr 4, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit Tiranë në06.02.2012,e përfaqësuar nga administratori ligjor i shoqërisë z. Kujtim Sejati që për qëllim të kësaj marrëveshje INTERPOSTA sh.p.k do tëquhet "Shoqëriae Përthithur".

DEKLARATA PARAPRAKE

A. Në përputhje me LigjinNr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",Pjesa IX, Neni 215 deri tek Neni 225, me propozim tëaksionerit të vetëm të shoqërisë hartohet kjo Projekt Marrëveshje për Bashkimin me përthithje tëInterposta sh.p.knga Posta Shqiptare sh.a.

B. Duke qenë se POSTA SHQIPTARE sh.a është zotëruese në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë INTERPOST sh.p.k, një shoqëri e themeluar më 06/02/2012.

C. Me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a në përputhje me objektivat e Shoqërisë, për të siguruar ofrimin e një impakti pozitiv në komunitet, me qëllim furnizimin me shërbime sa më të mira të të gjithë klientëve si dhe rritje të marzheve të fitimit, të cilat do të përmirësojnë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve në teknologji.

D. POSTA SHQIPTARE sh.a dhe INTERPOSTAsh.p.k dëshirojnë të kryejnë një Bashkim nëpërmjet të cilit POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë INTERPOST sh.p.k dhe shoqëria POSTA SHQIPTARE sh.a do të vazhdojë aktivitetin kurse INTERPOST sh.p.k do të çrregjistrohet pa kaluar në likujdim.

E. Më date 25.09.2015 sipas Urdhërit nr. 60106/1 dhe më datë10.12.2015, sipas urdhërit numër 6016/3, të Ministrit për Zhvillimin Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në cilësinë e aksionerit të vetëm të shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a është kërkuar: Fillimi i proceduravepër bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë INTERPOSTA sh.p.k nga shoqëria POSTA SHQIPTARE sh.a, dhe u ngarkua Eksperti Kontabël i Regjstruar Znj. Diana Golemi (Ylli) që të hartojë Raportin e Bashkimit me përthithje të INTERPOSTA sh.p.k me POSTA SHQIPTARE sh.a.

F. Me Vendimin nr.5 date 26.12.2015 të Asamblesë së Pergjithëshme të shoqërisë INTERPOST sh.p.k është miratuar: Fillimi i procedurave për bashkimin nëpërmjet përthithjes të shoqërisë INTERPOST sh.p.k me shoqërine POSTA SHQIPTARE sh.a dhe është ngarkuar administratori i shoqërisë për përgatitjen e dokumentave të Bashkimit me Përthithje.

G. Dy shoqëritë kanë rënë dakord për të hartuar këtë marrëveshje në mënyrë që të përcaktojnë afatet dhe kushtet e të drejtave dhe të detyrimeve respektive në përputhje me procesin e Bashkimit.

Të dyja shoqëritë kanë rënë dakord si mëposhtë vijon:

Neni 1

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Marrëveshje,përveçse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Marrëveshje"nënkupton këtë marrëveshje

"Shoqëri Përthithese" në këtë Marrëveshje do të thotë shoqëria POSTA SHQIPTARE sh.a

"Shoqëri e Përthithur"në këtëMarrëveshje do tëthotëshoqëria INTERPOSTA sh.p.k

"Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit" (Data Efektive e Bashkimit) ka kuptimin që i është dhënë në nenin2.1 që do të thotë data e miratimit të Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë

POSTA SHQIPTARE sh.a dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë INTERPOSTA sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit .

"Data e Bashkimit" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 2.4 që do të thotë data 31/12/2015.

"Informacion konfidencial" nënkupton çdo informacion, me shkrim ose me gojë në lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete të tjera të shoqërive POSTA SHQIPTARE sh.a dhe INTERPOST sh.p.k.

"Qenda Kombëtare e Regjistrimit" nënkupton njësinë administrative të themeluar në bazë të ligjit nr.9723, datë 03/04/2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

"Data e nënshkrimit" nënkupton datën e nënshkrimit të kësaj Projekt-Marrëveshje nga të dyja palët, ashtu siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj Marrëveshje.

Neni 2

BASHKIMI,KËMBIMI I AKSIONEVE

2.1 Në bazë të kushteve të kësaj Marrëvëshje POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë Interpost sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë INTERPOST sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 INTERPOST sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a tërësinë e elementeve të aktivit e të pasivit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Mbylljes.

2.3 Si rezultat i operacionit të Bashkimit, Kapitali aksionar i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në Datën Efektive të mbylljes mbetet i njejtë me kapitalin para bashkimit, me përjashtim nëse Raporti i Ekspertit nuk përcakton ndryshe. Kapitali themeltar i shoqërisë INTERPOSTA sh.p.k netohet në bilancin e konsoliduar të të dy shoqërive me vlerën e pjesëmarrjes.

2.4 Data e Bashkimit është data 31.12.2015që do të thotë që, të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga INTERPOST sh.p.k që nga data 01 janar 2016 deri në Datën e regjistrimit perfundimtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) do të konsiderohen si të kryera nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

2.5 Statuti i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a, mbas ndryshimeve që do t'i bëhen në Objektin e veprimtarisë do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

2.6 Anëtaret e Organeve drejtuese të Shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në datën e mbylljes do të vazhdojnë të jenë anëtarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.

2.7 Administrator i shoqërisë Përthithëse do të jetë z.Majlind Lazimi i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

Neni 3

EKSPERTËT

Me qëllim vlerësimin e kushteve të kësaj projekt-marrëveshje të bashkimit, për të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedure bashkimi me përthithje, emërohet znj. Diana Golemi (Ylli), e bija e Bajramit, e dtl. 19 tetor 1963, banuese në Tiranë, shtetase shqiptare, Eksperte Kontabël e Regjistruar, anëtare e IEKA, mbajtëse e licencës me nr.9, dt.10/02/2000.

Eksperti ngarkohet sipas ligjit të hartojë një raport me shkrim, nëpërmjet te cilit do të deklarojë dhe vlerësojë kapitalin e shoqërive.

Kapitali i shoqërisë përthithëse, (shoqërisë përfituese të kontributeve), pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithje me shoqërinë INTERPOSTA shpk (shoqëria kontribuese), do të përbëhet nga kapitalet e secilës prej shoqërive në momentin e realizimit të këtij procesi, vlerë e cila do të përcaktohet me paraqitjen nga Eksperti Kontabël i Regjistruar të raportit për modalitetet e bashkimit dhe vlerësimin e kapitaleve të dy shoqërive "Interpost" sh.p.k dhe " Posta Shqiptare" sh.a.

Shoqëritë pjesëmarrëse në këtë proces bashkimi me përthithje, garantojnë sipas ligjit se ekspertit do ti vihet në dispozicion i gjithë informacioni dhe dokumentat përkatëse, me qëllim kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme.

Neni 4

AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që INTERPOSTA sh.p.k t'i transferojë shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a tërësinë e elementeve të aktivit e të pasivit gjendje më datë 31.12. 2015.

Grupet kryesore të këtyre aktiveve dhe pasiveve më datë31dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 që janë marrë si bazë për hartimin e marrëveshjes së bashkimit paraqiten si vijon:

INTERPOSTA SH.P.K
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Vlerat janë në lekë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET		
Aktivet afatshkurtra		
Mjete monetare	126,707	1,109,317
Llogari të arkëtueshme tregtare	3,234,521	4,442,179
Kërkesa të tjera të arkëtueshme	54,090,593	43,737,726
Inventari	83,538	368,203
Totali aktiveve afatshkurtra	**57,535,358**	**49,657,425**
Aktivet afatgjata		
Aktive të qëndrueshme të trupezuara	80,475,674	111,570,378
Aktivet afatgjata jomateriale	-	75,722,711
Totali i aktiveve afatgjata	**80,475,674**	**187,293,089**
Totali i aktiveve	**138,011,032**	**236,950,514**
DETYRIMET		
Detyrimet afatshkurtra		
Të pagueshme ndaj furnitorëve	18,053,719	11,820,621
Të pagueshme ndaj punonjësve	261,581	-
Detyrime tatimore	-	545,730
Llogari të pagueshme të tjera	689,657,115	615,316,964
Totali i detyrimeve afatshkurtra	**707,972,415**	**627,683,315**
Detyrimet afatgjata		
Totali i detyrimeve afatgjata	-	-
Totali i detyrimeve	**707,972,415**	**627,683,315**
KAPITALI		
Kapitali themeltar	1,000,000	1,000,000
Fitim humbje	(570,961,382)	(391,732,801)
Total kapitali	**(569,961,382)**	**(390,732,801)**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit	**138,011,033**	**236,950,514**

Ndërkohë të dhënat e bilancit të POSTA SHQIPTARE Sha më datë 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 që janë marrë si bazë për hartimin e marrëveshjes së bashkimit janë si më poshtë:

POSTA SHQIPTARE SH.A
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Vlerat janë në lekë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	2,382,459,343	2,416,716,864
Aktivet afatgjata jomateriale	42,641,864	40,730,628
Llogari të tjera të arketueshme	450,000,000	450,000,000
Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara	1,000,000	1,000,000
Llogari të arkëtueshme të tjera	3,869,880	-
Total aktiveve afatgjata	**2,879,971,087**	**2,908,447,492**
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	206,608,970	206,498,951
Llogari të arkëtueshme tregtare	615,855,377	567,812,015
Llogari të arkëtueshme të tjera	1,031,725,403	1,200,466,124
Mjetet monetare në arkë e në bankë	2,531,829,423	2,364,237,428
Total aktive afatshkurtra	**4,386,019,173**	**4,339,014,518**
Total aktive	**7,265,990,260**	**7,247,462,010**
KAPITALI		
Kapitali aksionar	1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,320,891,974	1,380,951,364
Rezerva ligjore	114,735,189	103,250,221
Rezerva të tjera	1,239,614,352	1,044,369,902
Fitime të mbartura	72,127,716	12,068,326
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse	175,397,040	229,699,353
Total kapitali	**4,565,213,271**	**4,412,786,166**
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	185,224,294	194,319,765
Detyrime të tjera afatgjata	450,000,000	450,000,000
Total detyrime afatgjata	**635,224,294**	**644,319,765**
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	511,327,919	265,386,386
Detyrimet tatimore	91,916,542	36,823,680
Detyrime ndaj punonjësve	7,055,109	5,935,044
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera	9,035,308	10,894,081
Llogari të pagueshme të tjera	1,446,217,817	1,871,316,888
Total detyrime afatshkurtra	**2,065,552,695**	**2,190,356,079**
Totali i detyrimeve	**2,700,776,989**	**2,834,675,844**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	**7,265,990,260**	**7,247,462,010**

Mbas realizimit të operacionit të bashkimit të dhënat e bilancit të **POSTA SHQIPTARE sh.a** më datë 01.01.2016 mbas bashkimit me përthithje paraqiten si më poshtë:

POSTA SHQIPTARE SH.A (e bashkuar)
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Vlerat janë në lekë

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	2,462,935,017	2,528,287,242
Aktivet afatgjata jomateriale	42,641,864	116,453,339
Aktive afatgjata financiare	450,000,000	450,000,000
Llogari të arkëtueshme të tjera	3,869,880	-
Total aktive afatgjata	**2,959,446,761**	**3,094,740,581**
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	206,692,507	206,867,154
Llogari të arkëtueshme tregtare	619,089,898	572,254,194
Llogari të arkëtueshme të tjera	396,158,882	628,886,886
Mjetet monetare në arkë e në bankë	2,531,956,130	2,365,346,745
Total aktive afatshkurtra	**3,753,897,417**	**3,773,354,979**
Total aktive	**6,713,344,178**	**6,868,095,560**
KAPITALI		
Kapitali aksionar	1,642,447,000	1,642,447,000
Rezerva nga rivlerësimi	1,320,891,974	1,380,951,364
Rezerva të tjera	114,735,189	103,250,221
Rezerva ligjore	1,239,614,352	1,044,369,902
Fitime të mbartura	(319,605,085)	(183,537,024)
Fitimi i ushtrimit	(3,831,541)	33,571,902
Total kapitali	**3,994,251,889**	**4,021,053,365**
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	185,224,294	194,319,765
Detyrime të tjera afatgjata	450,000,000	450,000,000
Total detyrime afatgjata	**635,224,294**	**644,319,765**
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	529,381,638	277,207,007
Detyrimet tatimore	92,178,123	37,369,410
Detyrime ndaj punonjësve	7,055,109	5,935,044
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera	9,035,308	10,894,081
Llogari të pagueshme të tjera	1,446,217,817	1,871,316,888
Total detyrime afatshkurtra	**2,083,867,995**	**2,202,722,430**
Totali i detyrimeve	**2,719,092,289**	**2,847,042,195**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	**6,713,344,178**	**6,868,095,560**

Neni 5

MODALITETET

POSTA SHQIPTARE sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë INTERPOSTA sh.p.k në datën e bashkimit. Në mënyre të përmbledhur jane dhene ne pasqyrën e pozicionit financiar te shoqerise INTERPOST sh.p.k ne nenin 4 te marrveshjes kurse te analizuara te gjitha aktivete dhe pasivet jepen ne pasqyrat nr 1,1/1,1/2,1/3,2,2/1,2/2,2/3,2/4,3,3/1,3/2, qe jane pjese e kesaj marrveshje.

POSTA SHQIPTARE sh.a në daten Efektive të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, licensat e zotëruara nga INTERPOST sh.p.k në këtë datë.

Punonjësit e shoqërisë INTERPOST sh.p.k do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës të POSTA SHQIPTARE sh.a. keta punonjes jane:

NR	Nr. Sigurimeve	Emer mbiemer
1	F60705151O	Kujtim sejati
2	G75411135A	Hena Rustemllari
3	I80427072V	Evis Mahmutaj
4	I11120097D	Elton Rama
5	I70730058J	Donald Islami
6	I41113034O	Elton projko
7	I95917050N	Romina Marqeshi
8	I20504074L	Alfred Hodo
9	I20724062C	Andi Llanaj

Neni 6

GARANCITË PËR KREDITORËT DHE MBROJTJA E TYRE

Themelore në këtë procedurë bashkimi me përthithje e shoqërive të mësipërme, është garantimi i kreditorëve të shoqërive të përfshira në këtë bashkim, sidomos ata të shoqërisë së përthithur (nëse ka), për faktin se megjithëse debitori fillestar humbet (pra shoqëria e përthithur), detyrimet e saj sipas ligjit i transferohen shoqërisë përthithese POSTA SHQIPTARE sh.a.

Shoqëria përthithese merr përsipër sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretët, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti drejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithese

Neni 7

DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisëINTERPOSTA sh.p.k nga data 1 janar 2016 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKR-së, datënë të cilin do të ndodhi cregistrimi pa likujdim i shoqërisëINTERPOSTA shpk, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithese POSTA SHQIPTARE sh.a. dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.
Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31dhjetor 2015, bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dyja shoqërive i datës 31.12.2015.

Neni 8

DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë Marrëveshje bashkimi me përthithje, janë hartuar duke ju referuar datës 31.12.2015, si për shoqërinë përthithese ashtu edhe për shoqërinë e përthithur.

Neni 9

RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që INTERPOST shpk zotërohet 100% nga POSTA SHQIPTARE sh.a, nuk ka raporte të këmbimit të kapitalit.

Neni 10

SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

Neni 11

TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

Neni 12

PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

a) Të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Marrëveshje si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
b) Të njoftojnë Bankën e Shqipërisë në lidhje me operacionin e bashkimit që po kryejnë.
c) Të ndërmarrin çdo veprim për depozitim e të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit pas miratimit nga Asambleja e Përgjithshme për ti dhënë efekt Bashkimit në Datën Efektive.

Neni 13

MBYLLJA E OPERACIONIT

Mbyllja e operacionit të Bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në adresën: Rruga Reshit Çollaku, nr 4, (me adrese sekondare të ushtrimit të aktivitetit në Terminal Center,pranë Spitalit Hygeia,Kthesa e Kamzes) Tiranë, sa më shpejt të jetë e mundur.
Në mbyllje,ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorëzimin e dokumentave të mëposhtme:

a) Të gjithë vendimeve të Asambleve dhe Këshillit Mbikqyrës në lidhje me këtëoperacion.
b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm.
c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse.

Neni 14

DEKLARIMET DHE GARANCITE

Deklarimet dhe Garancitë e POSTA SHQIPTARE sh.a:

- POSTA SHQIPTARE sh.a dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- POSTA SHQIPTARE sh.a nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirjeose në proces likujdimi.

Deklarimet dhe Garancite e INTERPOSTA sh.p.k:

- INTERPOST sh.p.k dhe perfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- INTERPOST sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likujdimi.

Neni 15

ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë para Datës së Mbylljes me aprovimin me shkrim të të dyja paleve.
Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë me anë të njoftimit me shkrim te pala tjetër, para Datës së Mbylljes, nëse Bashkimi nuk përfundon.

Neni 16

KONFIDENCIALITETI

Palët do tëtrajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përftuara si rezultat i nisjes dhe përmbushjes së kësajMarrëveshje, të cilat kanë lidhje me negociatat, përmbushjen dhe mbylljen e kësaj Marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo marrëveshje.
Palët mundt'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar
c) Me miratimin parapark me shkrim të palës tjetër.

Neni 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo marrëveshje rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18

TË PËRGJITHSHME

Përfaqësuesit ligjor të shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedure bashkimi me përthithje, kanë hartuar sipas ligjit (nenit 216) një raport të hollësishëm, në të cilin shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe bazat ligjore dhe ekonomike për të, vështirësitë e veçanta të vlerësimit, të cilat mund të jenë hasur. Raporti ka përshkruar edhe pasojat e këtij bashkimi mbi punëmarrësit e shoqërive pjesëmarrëse.

Projekt marrëveshja bashkimi dhe raporti janë depozituar sipas ligjit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, më herët 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për marrjen e vendimit të përcaktuar në nenin 218 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", duke publikuar edhe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.

Autorizohet z. Desar Peçi të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për depozitimin e të gjitha akteve për realizimin e kësaj procedure të bashkimit me përthithje.

Neni 19

TË NDRYSHME

a) Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kërkuara apo dhe të lejuara nga kjo Marrëveshje do të dorëzohen dorazi ose me anë të postës në adresën si më poshtë vijon, derisa Palët të njoftojnë njëri-tjetrin për ndryshime të adresave të tyre.

Për POSTA SHQIPTARE sh.a:	Për INTERPOST sh.p.k:
Rruga Reshit Çollaku, nr 4, Tiranë	Rruga Reshit Çollaku, nr 4, Tiranë
Në vëmendje të: z. Majlind Lazimi	Në vëmendje të: z. Kujtim Sejati

b) Ndryshime

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të jetë i vlefshëm përvecse me shkrim dhe e nënshkruar nga palët.

Kjo marrëveshje u hartua sot më datë_____, në 6 kopje orgjinale dhe u nënshkrua nga:

Shoqëria
POSTA SHQIPTARE SH.A
Përfaqësuar nga:

z. Majlind Lazimi
Administrator

Shoqëria
INTERPOST SH.PK
Përfaqësuar nga:

z. Kujtim Sejati
Administrator

Nr pro 65

dt. 01.07.2016

RAPORT

I BASHKIMIT MË PËRTHITHJE TË INTERPOST SHPK NGA POSTA SHQIPTARE SHA

SHOQERIA "INTERPOST" SHPK

Ky Raport bashkimi me përthithje është hartuar në përputhje me nenin 216 Nr.9901, datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE pika 2: Raporti i bashkimit nga :

- **Administratori i shoqërisë Interpost sh.p.k z. Kujtim Sejati**

Bashkimi me përthithje është iniciuar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të INTERPOST sh.p.k nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

INTERPOST shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital themltar të regjistruar prej 1,000,000 lekë, i ndarë në 1,000 kuota me vlerë 1,000 lekë/kuotë, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Rrugën Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë, rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë më 06.02.2012.

Projekt marrëveshja e bashkimit është hartuar në respektim të plotë të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", nenet 215, 216-225, ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a në përputhje me objektivat e Shoqërisë, për të siguruar ofrimin e një impakti pozitiv në komunitet, me qëllim furnizimin me shërbime sa më të mira të të gjithë klientëve si dhe rritje të marzheve të fitimit, të cilat do të përmirësojnë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve në teknologji

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Raport Bashkimi, përvecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Raport Bashkimi" nënkupton këtë Raport Bashkimi

"Shoqëri Përthithese" do të thotë shoqëria "POSTA SHQIPTARE" sh.a

"Shoqëri e Përthithur" do të thotë shoqëria "INTERPOST" sh.p.k

"Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit " (Data Efektive e Bashkimit) që do të thotë data e miratimit të Projekt-Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit .

"Data e Bashkimit" do të thotë data 31/12/2015.

Në lidhje me këtë bashkim të dy shoqërite kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. BASHKIMI, KËMBIMI I AKSIONEVE

1.1 Në bazë të kushteve të Projekt Marrëveshjes se lidhur, POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë Interpost sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të Projekt Marrëveshjes nga Aksioneri i vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1.2 Interpost sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a tërësinë e elementeve të aktivit e të pasivit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.

1.3 Si rezultat i operacionit të Bashkimit, Kapitali aksionar i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në Datën Efektive të Bashkimit mbetet i njëjtë me kapitalin para bashkimit. Kapitali themeltar i shoqërisë Interpost sh.p.k netohet në bilancin e konsoliduar të të dy shoqërive me vlerën e pjesëmarrjes.

1.4 Data e Bashkimit është data 31.12.2015 që do të thotë se të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga Interpost sh.p.k që nga data 01 Janar 2016 deri në Datën e regjistrimit përfundimtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) do të konsiderohen si të kryera nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

1.5 Statuti i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a, mbas ndryshimeve që mund t'i behen në Objektin e veprimtarisë do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

1.6 Anëtarët e Organeve drejtuese të Shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të vazhdojnë të jenë anetarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.

1.7 Administrator i shoqërisë Përthithëse do të jetë Z.Majlind Lazimi i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

2. AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që Interpost sh.p.k t'i transferojë shoqërisë Posta Shqiptare sh.a tërësinë e elementëve të aktivit e të pasivit gjendje më datë 31.12. 2015.

3. MODALITETET

Shoqeria "Posta Shqiptare" sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Interpost sh.p.k në datën e bashkimit.

Shoqeria "Posta Shqiptare" sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, liçensat e zotëruara nga Interpost sh.p.k në këtë datë.

Punonjësit e shoqërisë Interpost sh.p.k do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës tek Posta Shqiptare sha.

4. DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë Interpost sh.p.k nga data 1 Janar 2016 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKR-së, datë në të cilin do të ndodhi çregjistrimi pa likujdim i shoqërisë Interpost shpk, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithese "Posta Shqiptare" sh.a dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31 Dhjetor 2015 bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dy shoqërive i datës 31.12.2015.

5. DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë projekt bashkimi me përthithje, janë hartuar duke j'u referuar datës 01.01.2015, si për shoqërinë përthithëse ashtu edhe për shoqërinë e përthithur. Ndërkohë që për hartimin e marrëveshjes përfundimtare të bashkimit me përthithje llogaritë dhe kushtet financiare të bashkimit do të përcaktohen nga bilanci kontabël i datës 31.12.2015.

6. RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që Interpost shpk zotërohet 100% nga Posta Shqiptare sh.a, nuk ka raporte të këmbimit të kapitalit.

7. SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

8. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

9. PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

a) të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Raport si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
b) të ndërmarrin çdo veprim për depozitim të të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

10. MBYLLJA E OPERACIONIT

10.1.Mbyllja e operacionit të Bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në adresën: Rruga Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë; sa më shpejt të jetë e mundur.

10.2. Në mbyllje, ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorezimin e dokumentave të mëposhtme:

a) të gjithë vendimeve të Ortakut të Vetëm në lidhje me këtë operacion.
b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm
c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse.

11. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Deklarimet dhe Garancitë e INTERPOST sh.p.k:

- Interpost sh.p.k dhe përfaqësuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Marrëveshje dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- Interpost sh.p.k nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likujdimi.

12. KONFIDENCIALITETI

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përftuara si rezultat i nisjes dhe përmbushjes së ketij Raporti Bashkimi, të cilat kanë lidhje me negociatat, përmbushjen dhe mbylljen e kësaj Marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo marrëveshje.

Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar
c) Me miratimin parapark me shkrim të palës tjetër.

13. MBROJTJA E KREDITORËVE

Shoqëria përthithese merr përsiper sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretet, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti kundrejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithese.

14. LIGJI I ZBATUESHËM

Ky Raport Bashkimi rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

15. TË NDRYSHME

Ky raport i shoqërisë mbi procedurat e bashkimit me përthithje të shoqërive u hartua nga administratori i shoqërisë, sipas ligjit dhe do të depozitohet së bashku me projekt marrëveshjen e bashkimit me përthithje pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria INTERPOST SH.P.K

Z. Kujtim Sejati
Administrator

POSTA SHQIPTARE SH.A
NR. 2063/1 Prot
Date 01. 07. 2016

RAPORT

I BASHKIMIT ME PËRTHITHJE TË INTERPOST SHPK NGA POSTA SHQIPTARE SHA

SHOQERIA "POSTA SHQIPTARE" SH.A

POSTA SHQIPTARE

Ky Raport bashkimi me përthithje është hartuar në përputhje me nenin 216 Nr.9901, datë 14.4.2008 "PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" pika 2: Raporti i bashkimit nga :

- **Z.Majlind Lazimi Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë "Posta Shqiptare" Sha**

Bashkimi me përthithje është iniciuar nga aksioneri i vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare sh.a, për realizimin e procesit të bashkimit me përthithje të INTERPOSTA sh.p.k nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

POSTA SHQIPTARE sh.a, shoqëri anonime me kapital të regjistruar prej 1,642,447,000 lekë, i ndarë në 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion, tërësisht i paguar, me adresë të regjistruar në Rrugën Rreshit Çollaku, nr 4, Tiranë dhe krijuar me vendimin e gjyaktës Tiranë nr. 20718, datë 03.02.1992.

Projekt marrëveshja e bashkimit është hartuar në respektim të plote të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare", nenet 215,216-225, ligji 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Me qëllim përmirësimin e performancës ekonomike të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a në përputhje me objektivat e Shoqërisë, për të siguruar ofrimin e një impakti pozitiv në komunitet, me qëllim furnizimin me shërbime sa më të mira të të gjithë klientëve si dhe rritje të marzheve të fitimit, të cilat do të përmirësojnë flukset e parasë dhe rritjen e investimeve në teknologji.

PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Në këtë Raport Bashkimi, përvecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilësohet ndryshe më tej, fjalet e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

"Raport Bashkimi" nënkupton këtë Raport Bashkimi

"Shoqëri Përthithese" do të thotë shoqëria "POSTA SHQIPTARE" sh.a

"Shoqëri e Përthithur" do të thotë shoqëria "INTERPOST" sh.p.k

"Data e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit " (Data Efektive e Bashkimit) që do të thotë data e miratimit të Projekt-Marrëveshjes nga Aksioneri i Vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit .

"Data e Bashkimit" do të thotë data 31/12/2015.

Në lidhje me këtë bashkim të dy shoqërite kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

POSTA SHQIPTARE

1. BASHKIMI, KËMBIMI I AKSIONEVE

1.1 Në bazë të kushteve të Projekt Marrëveshjes se lidhur, POSTA SHQIPTARE sh.a do të përthithë shoqërinë Interpost sh.p.k në Datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit (Data Efektive e Bashkimit) që është data e miratimit të Projekt Marrëveshjes nga Aksioneri i vetëm i shoqërisë Posta Shqiptare dhe Ortaku i vetëm i shoqërisë Interpost sh.p.k dhe i depozitimit të këtyre dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

1.2 Interpost sh.p.k do t'i transferojë shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a tërësinë e elementeve të aktivit e të pasivit duke përfshirë edhe ato që rezultojnë nga operacionet e kryera gjatë periudhës ushtrimore deri në Datën Efektive të Bashkimit.

1.3 Si rezultat i operacionit të Bashkimit, Kapitali aksionar i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në Datën Efektive të Bashkimit mbetet i njëjtë me kapitalin para bashkimit. Kapitali themeltar i shoqërisë Interpost sh.p.k netohet në bilancin e konsoliduar të të dy shoqërive me vlerën e pjesëmarrjes.

1.4 Data e Bashkimit është data 31.12.2015 që do të thotë se të gjitha dhe çdo operacion i kryer nga Interpost sh.p.k që nga data 01 Janar 2016 deri në Datën e regjistrimit përfundimtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) do të konsiderohen si të kryera nga POSTA SHQIPTARE sh.a.

1.5 Statuti i shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a, mbas ndryshimeve që mund t'i behen në Objektin e veprimtarisë do të vazhdojë të jetë edhe Statuti i Shoqërisë Përthithëse.

1.6 Anëtarët e Organeve drejtuese të Shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të vazhdojnë të jenë anetarët e organeve të Shoqërisë Përthithëse.

1.7 Administrator i shoqërisë Përthithëse do të jetë Z.Majlind Lazimi i cili do të ushtrojë kompetencat e administrimit të shoqërisë së bashkuar sipas ligjit dhe statutit të shoqërisë.

2. AKTIVET DHE DETYRIMET E PARASHIKUARA PËR TU TRANSFERUAR

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikohet që Interpost sh.p.k t'i transferojë shoqërisë Posta Shqiptare sh.a tërësinë e elementëve të aktivit e të pasivit gjendje më datë 31.12.2015.

3. MODALITETET

Shoqeria "Posta Shqiptare" sh.a do të jetë zotëruese e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Interpost sh.p.k në datën e bashkimit.

Shoqeria "Posta Shqiptare" sh.a në datën e Realizimit Përfundimtar të Bashkimit do të zotërojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, liçensat e zotëruara nga Interpost sh.p.k në këtë datë.

POSTA SHQIPTARE

Punonjësit e shoqërisë Interpost sh.p.k do të përfshihen mbas datës së bashkimit si punonjës tek Posta Shqiptare sha.

4. DATA KONTABËL

Në aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë Interpost sh.p.k nga data 1 Janar 2016 deri në datën e regjistrimit përfundimtar të procesit të bashkimit pranë QKR-së, datë në të cilin do të ndodhi çregjistrimi pa likujdim i shoqërisë Interpost shpk, do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithese "Posta Shqiptare" sh.a dhe regjistrimet kontabël përkatëse do të merren në librat e saj.

Duke qënë se data mbi të cilën do të bëhet bashkimi është data 31 Dhjetor 2015 bilanci përfundimtar i përthithjes do të jetë bilanci i të dy shoqërive i datës 31.12.2015.

5. DATA E PËRGATITJES (HARTIMIT) TË LLOGARIVE

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit për këtë projekt bashkimi me përthithje, janë hartuar duke j'u referuar datës 01.01.2015, si për shoqërinë përthithëse ashtu edhe për shoqërinë e përthithur. Ndërkohë që për hartimin e marrëveshjes përfundimtare të bashkimit me përthithje llogaritë dhe kushtet financiare të bashkimit do të përcaktohen nga bilanci kontabël i datës 31.12.2015.

6. RAPORTET E KËMBIMIT

Duke konsideruar që Interpost shpk zotërohet 100% nga Posta Shqiptare sh.a, nuk ka raporte të këmbimit të kapitalit.

7. SHUMA E PARASHIKUAR E PRIMIT TË BASHKIMIT

Nga operacioni i mësipërm nuk do të rezultojë prim nga bashkimi.

8. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

9. PREMTIME DERI NË MBYLLJE

Deri në datën e mbylljes, Palët duhet që:

a) të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar këtë Raport si dhe dokumentat e tjera në lidhje me to.
b) Të njoftoj Bankën e Shqipërisë në lidhje me operacionin e bashkimit që po kryen.
c) të ndërmarrin çdo veprim për depozitim të të gjitha dokumentave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

POSTA SHQIPTARE

10. MBYLLJA E OPERACIONIT

10.1.Mbyllja e operacionit të Bashkimit do të bëhet në selinë e shoqërisë POSTA SHQIPTARE sh.a në adresën: Rruga Rreshit Çollaku, nr 4, Adresa sekondare e ushtrimi te aktivitetit ne "Terminal Center" Kthesa e Kamzes, Kati i dyte, Tiranë; sa më shpejt të jetë e mundur.

10.2. Në mbyllje, ose para saj palët duhet të kenë bërë të mundur realizimin dhe dorezimin e dokumentave të mëposhtme:

a) Të gjithë vendimeve të Keshillave Mbikqyrës në lidhje me këtë operacion.
b) Njoftimet përkatëse në zyrat e taksave në lidhje me operacionin e mësipërm.
c) Kalimin e punonjësve nga Shoqëria e Përthithur në shoqërinë përthithëse.

11. DEKLARIMET DHE GARANCITË

Deklarimet dhe Garancitë e POSTA SHQIPTARE sh.a:

- POSTA SHQIPTARE sh.a dhe përfaqesuesi i saj ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer këtë Raport Bashkimi dhe çdo dokument tjetër që duhet kryer në përputhje me këtë të fundit.

- POSTA SHQIPTARE sh.a nuk është në një proces falimentimi (apo procese të tjera të ngjashme), në shkrirje ose në proces likujdimi.

12. KONFIDENCIALITETI

Palët do të trajtojnë në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet e marra dhe të përftuara si rezultat i nisjes dhe përmbushjes së ketij Raporti Bashkimi, të cilat kanë lidhje me negociatat, përmbushjen dhe mbylljen e kësaj Marrëveshje ose të çdo dokumenti që referohet nga kjo marrëveshje.

Palët mund t'i japin informacion një pale të tretë, i cili mund të konsiderohet konfidencial nëse:

a) Kërkohet nga ligji ose me qëllim të ndonjë procedure ligjore
b) Kërkohet nga ndonjë institucion qeveritar
c) Me miratimin parapark me shkrim të palës tjetër.

13. MBROJTJA E KREDITORËVE

Shoqëria përthithese merr përsiper sipas ligjit të bëhet pasardhëse e shoqërisë së përthithur në marrëdhënie me të tretet, duke garantuar në këtë mënyrë kreditorët e shoqërisë së përthithur ti kundrejtojnë pretendimet e tyre ndaj shoqërisë përthithese.

14. LIGJI I ZBATUESHËM

POSTA SHQIPTARE

Ky Raport Bashkimi rregullohet në të gjitha aspektet nga ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

15. TË NDRYSHME

Ky raport i shoqërisë mbi procedurat e bashkimit me përthithje të shoqërive u hartua nga administratori i shoqërisë, sipas ligjit dhe do të depozitohet së bashku me projekt marrëveshjen e bashkimit me përthithje pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria "POSTA SHQIPTARE" SH.A

z. Majlind Lazimi
Administrator